



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.04.2025

Numër Protokolli: 2373/2025

A.nr.425/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari–anëtarë, me Çlirim Zeka–në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.425/2025 të datës 07.03.2025 të parashtruar nga ankuesi S.R, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike *‘Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës’*, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Pezullohet procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr.425/2025 e datës 07.03.2025 të parashtruar nga ankuesi S.R.

A r s y e t i m

Ankuesi S.R (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), me datë 07.03.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1476/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor lidhur me refuzimin e kërkesës për pensionim të parakohshëm nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi Sami Rexhepi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 02/651/09 të datës 30.05.2014 është i punësuar në pozitën *‘Inspektor Tatimor i nivelit I’* në Departamentin Drejtoria Operacionet Përmbushëse në Administratën Tatimore të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Avokati i Popullit ka parashtruar kërkesë me numër protokolli KPD/538/2024 me datë 25.07.2024 tek Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të nenit 9 (paragrafët 5 dhe 7), nenit 14, nenit 16, nenit 26, nenit 79, paragrafi 4, nenit 89, paragrafi 12 të Ligjit nr.08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, ku në pikën 18 thekson se: *Avokati i Popullit konsideron se në rastin e Ligjit të kontestuar është përjashtuar krejtësisht mundësia e inicimit të procedurave në KPMSHCK, nga punonjësit e ATK-së.*

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se shqyrtimi dhe vendosja e ankesës së ankuesit varet nga vendosja nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës lidhur me të punësuarit në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe e njëjta konsiderohet si parakusht për zgjidhjen e çështjes, ashtu që në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar parakushtet ligjore që të pezullohet kjo procedurë administrative në kuptim të nenit 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bënë pezullimin e kësaj çështje juridike administrative deri në vendosjen nga Gjykata Kushtetuese lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit.

Kështu që theksuar si më sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 85 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.425/2025

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit S.R;
- Administratës Tatimore të Kosovës (Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.